



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Tiranë; Tel-Fax: 04-228485
E-mail: bleskaj@klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. 341/1 Prot.

Tiranë, më 31/03/2020

U R D H Ë R
Nr. 47, Datë 31/03/2020

P Ë R
PËRGATITJEN E GUIDËS MBI REFERIMIN NË PROKURORI TË
VEPRAVE PENALE, SI DHE PËRDITËSIMIN E MANUALIT TË LUFTËS
KUNDËR KORRUPSIONIT

Në mbështetje të Ligjit nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në linjë me rekomandimet e Progres Raportit 2019 të Bashkimit Europian për Shqipërinë, në përputhje me përditësimet më të fundit dhe të vazhdueshme të standardeve audituese nga organizata jonë mëmë, INTOSAI, si edhe për një arritje të suksesshme të objektivave të vendosura në Strategjinë institucionale 2018-2022, duke reflektuar eksperiencën e akumuluar deri më tani nga projekti IPA, bashkëpunimin me SIGMA-n, USAID dhe partnerë të tjerë vendas dhe të huaj, si dhe në vijim të Urdhërit Nr. 44, datë 31.03.2020 "Për përditësimin dhe përmirësimin e Manualeve të Auditimit të Performancës, Auditimit të Buxhetit, Auditimit Financiar dhe Auditimit të Përputhshmërisë",

U R D H Ë R O J:

1. Ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e Guidës mbi Referimin në Prokurori të Veprave Penale, si dhe për rishikimin dhe përmirësimin e Manualit të Luftës Kundër Korrupsionit.
2. Grupi i punës do të përbëhet nga:
 - Z. Koço Sokoli (Drejtues grupi)
 - Z. Gjovalin Preçi (Anëtar)
 - Qeram Cibaku (Anëtar)
 - Z. Gjon Ndreja (Anëtar), marrëdhëniet e punës si ekspert i jashtëm fillojnë më

datë 15.04.2020.

- Z. Rysisim Xhaja (Anëtar)
- Elira Elezi (Anëtar)

Ky grup pune do të punojë për:

- Përditësimin/ripunimin e Manualit të Auditimit të Luftës Kundër Korrupsionit.
 - Drafti paraprak paraqitet për komente tek Departamentit Juridik, Drejtorëve të Përgjithshëm, Drejtorit të Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtorëve të Departamenteve, më datë 10.05.2020.
 - Komentet i përcillen grupit të punës brenda datës 25.05.2020.
 - Drafti i ripunuar paraqitet te Kryetari i KLSH^{së} më datë 10.06.2020,
 - Materiali do të miratohet brenda datës 30.06.2020.
- Hartimin e Guidës për Referimin në Prokurori të Veprave Penale
 - Drafti paraprak paraqitet te Kryetari i KLSH^{së} më datë 10.05.2020.
 - Miratimi do të kryhet mbas nënshkrimit të rinovimit të marrëveshjes me Prokurorin e Përgjithshëm, duke reflektuar edhe kërkesat e kësaj marrëveshje, por jo më vonë se data 30.05.2020.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Bujar LESKAJ

